



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:153678

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05694426

P.nr.253/2023

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qendresa Tahiri- Islami, në çështjen penale ndaj të pandehurit Z.B, për shkak të veprës penale-Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25 (tutje:KPPK), duke vendosur sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.269/2006, të datës 29.09.2006, sipas detyrës zyrtare me datën 16.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET aktakuza e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.269/2006, e datës 29.09.2006, dhe **pushohet** procedura penale ndaj të pandehurit Z.B, me nofkën “.....”, nga i ati....., e ëma, e vajzërisë, lindur më datë, në fshatin Kernjin e Epërme, komuna e Leposaviqit, serb, Shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale- Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së, **për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.**

II. Në mbështetje të nenit 328 par.5 të KPPK-së dhe nenit 276 par.1 të KPP-së, URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i pushkës automatike M-70 AB nr.2 me numër serik 365624 të cal 7.62mm dhe karikatori së bashku me 28 plumba të cal. 7.62mm. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo armë së bashku me municionin duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

III. Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.

IV. E dëmtuara J.B, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohet në kontest të rregulltë civil

A r s y e t i m

Ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.nr.269/2006, të datës 29.09.2006, ndaj të pandehurit Z.B, për shkak të veprës penale-Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së.

Gjykata Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Krimeve të Rënda ka nxjerr aktvendimin P.nr.330/06 të datës 05.02.2019 me të cilin është hedhur aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe është pushuar procedura penale ndaj të pandehurit Z.B për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë me datën 15.02.2019 ia ka drejtuar Gjykatës së Apelit ankesën kunder aktvendimit P.nr.330/06 të datës 05.02.2019 me të cilin është hedhur aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë me të cilën ka kërkuar që lënda të kthehet ne rigjykim pasi që vendimi i lartë cekur është përfshirë në shkelje esencilale të dispozitave të KPP-së, kur Gjykata Themelore në Mitrovicë nuk ka vendosur lidhur me konfiskimin e armës me të cilën pretendohet se është kryer vepra penale.

Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Shtetit, ka prishur aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim me arsyetimin se Aktvendimi i gjykatës është përfshirë në shkelje pasi që gjykata nuk ka vendosur lidhur me konfiskimin e armës me të cilën dyshohet se është kryer vepra penale e lartë cekur, pasi që arma i nënshtrohet konfiskimit të përhershëm.

Në nenin 90, paragrafi 1, nën-paragrafi 3 të KPPK-së, përcaktohet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar: *“dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim”*. Ndërkaq, sipas nenit 91, par.1 të KPPK-së, *“afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale”*, paragrafi

3 përcakton: *“Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer”*, ndërsa paragrafi 4 parasheh: *“Afati i parashkrimit ndërpritet po ashtu kur kryerësi kryen një vepër tjetër penale me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit”*.

Gjykata, nga shkresat dhe provat që gjenden në këtë lëndë penale si dhe nga rrethanat e këtij rasti, konstaton se nuk është paraqitur asnjë nga rrethanat që do të ndalonte rrjedhën e parashkrimit të ndjekjes penale, në afatin dhejtë (10) vjeçar, afat ky i paraparë për parashkrim relativ për këtë vepër penale.

Në rastin konkret i pandehuri është akuzuar për kryerjen e veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së, për të cilën vepër penale parashihet dënimi me gjobë dhjetë mijë (10.000) euro ose me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Sipas aktakuzës, i pandehuri këtë vepër penale dyshohet ta ketë kryer me datën 06.05.2006, ndërsa veprimi i fundit i ndërmarrë në drejtim të ndjekjes penale është ndërmarrë më datë 02.02.2007, kur është nxjerr aktvendimi për konfirmimin e aktakuzës dhe nga kjo datë, e deri më tani, nuk është ndërmarr asnjë veprim në drejtim të ndjekjes penal.

Rrjedhimisht, gjykata konstaton se nga data 02.02.2007, datë kur është nxjerr aktvendimi për konfirmimin e aktakuzës, e deri më tani kanë kaluar më shumë se shtatëmbëdhjetë (17) vjet, dhe se brenda kësaj periudhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim me qëllim të ndjekjes penale, që do të ndërpriste rrjedhën e afatit të parashkrimit relativ, çka do të thotë se ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale në bazë të nenit 90, par. 1, nënpar 3 të KPPK-së. Saktësisht, parashkrimi relativ i ndjekjes penale në këtë rast penal ka arritur me datë 02.02.2017, ditë kjo kur janë mbushur dhjetë (10) vjet nga dita kur është ndërmarrë veprimi i fundit në drejtim të ndjekjes penale, ngase brenda kësaj periudhe kohore nuk është ndërprerë rrjedha e afatit të parashkrimit dhe nuk ka përfunduar ndjekja penale.

Gjykata, bazuar në verifikimet që janë bërë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, përmes Zyrës për Menagjimin e Lëndëve, ka vërtetuar se ndaj të pandehurit Z.B përveç kësaj lënde nuk janë zhvilluar edhe procedura tjetër.

Bazuar në nenin 91, par. 4 të KPK-së, rrjedh se afati i parashkrimit ndërpritet kur kryerësi kryen një vepër tjetër penale **me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para**

skadimit të afatit të parashkrimit. Referuar verifikimit të lartcekur del se i pandehuri nuk është i dënuar me asnjë aktgjykim tjetër të plotfuqishëm, që do ta ndërpriste rrjedhën e afatit të parashkrimit.

Gjykata konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale ashtu që, pamundëson ligjërishit që Gjykata të ndërmerrë ndonjë veprim në drejtim të ndjekjes penale e për pasojë është rrethanë që pengon ndjekjen penale, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi që të hedh aktakuzën e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.269/2006, të datës 29.09.2006 dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit Z.B, për veprën penale-Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

Gjykata vendosi si në pikën –II- të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 328 par.5 të KPPK-së, lidhur me nenin 276 par.1 të KPP-së, ashtu që ndaj të pandehurit urdhëroi konfiskimin e përhershëm të pushkës automatike M-70 AB nr.2 me numër serik 365624 të cal 7.62mm dhe karikatorit së bashku me 28 plumba të cal. 7.62mm e cila armë pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës sipas procedurave ligjore në fuqi.

Aktvendimin mbi parashkrimin relativ Gjykata e mori në kuptim të nenit 90 par.1, nënpar.3 të KPPK-së, lidhur me nenin 357 par.1, nën par.1.3 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (KPP).

Vendimin mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, e mori në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 462 par.1 dhe par.3 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Nga arsyet e lartcekura e në kuptim të nenit 90, par. 1 nënpar.3 të KPPK-së e lidhur me nenin 357 par. 1, nën par.1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti I Përgjithshëm- Divizioni Penal
P.nr.253/23, me datë 16.05.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Qendresa Tahiri- Islami

KËSHILLË JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tre (3) ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.